



Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

Parimi: Keqbërjet dhe krimet e luftës nuk duhet të atribuohen kolektivisht

Studim i rastit



Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërlihen me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit.¹ Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kruciale që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Keqbërjet dhe krimet e luftës nuk duhet të atribuohen kolektivisht”.

Keqbërjet dhe krimet e luftës nuk duhet të atribuohen kolektivisht

Keqbërjet dhe krimet e luftës nuk duhet t'i atribuohen kolektivisht një grupi ose etnie, por janë individët që duhet të mbahen përgjegjës për krimet e tyre që lidhen me konfliktin. Përderisa është e rëndësishme të luftohet mosndëshkueshmëria dhe të kërkohet drejtësi për viktimat përmes gjykimeve penale për t'i mbajtur ata persona përgjegjës për krimet e ndodhura, është po ashtu e papranueshme që të fajësohen pjesë të caktuara të një grupi apo bashkësie etnike për këto krime. Përgjegjësia penale është individuale, prandaj, vetëm individit mund të ndiqet penalisht. Atribuimi i krimeve të luftës në mënyrë kolektive ndaj një grupi ose etnie do të parandalojë procesin e vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe do të pengojë procesin e pajtimit. Nuk mund të kërkohet përgjegjësi nga një komb i tërë nëse qeveria e tij urdhëroi akterë shtetëror dhe jo-shtetëror të kryejnë krime lufte kundër civilëve të paarmatosur.

Hyrje

Përgjegjësia penale është kategori individuale, e cila i referohet vetëm kryerësit të veprës penale dhe si e tillë, çdo kryerës përgjigjet vetëm për veprimin apo mosveprimin e tij². Andaj çdo krim lufte, apo krime të tjera të cilat ndërlihen me konfliktin, duhet të i atribuohen vetëm kryerësve penalisht përgjegjës për ato krime. Kjo për arsyen se vet Kodi Penal veprën penale dhe përgjegjësinë penale ia referon vetëm personave fizik, të cilët janë mendërisht të aftë në kohën e kryerjes së veprës penale. Në nenin 17 të këtij Kodi, përkatësisht në paragrafin e parë të tij, thuhet se “Kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia³”. Rrjedhimisht vetëm personat të cilët janë të përgjegjshëm penalisht mund të përgjigjen për krimet e kryera, e jo edhe ata të cilët nuk kanë përgjegjësi penale. Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovës duhet të i atribuohen vetëm atyre që i kanë kryer dhe jo grupit etnik të kryerësve të krimeve.

Në diskursin tonë publik, shpesh krimet e luftës i atribuohen një etnie të caktuar, përkundër faktit të normimit të përgjegjësisë penale individuale. Prandaj personat të cilët nuk i përkasin lëmisë juridike, shpesh bien pre e një diskursi të tillë, duke e konsideruar këtë fakt si të mirëqenë. Ne duhet të ndalojmë praktikën e deritanishme ku individë të ndryshëm janë fajësuar padrejtësisht për shkak të etinsë apo grupit të cilit ata i përkasin, duke i rekomanduar të gjitha institucionet vendimmarrëse që të ndërmarrin masat e duhura.

¹ Principi ALB (vshr-ks.org)

² Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Neni 17, Pika 12, Faqe 74

³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 17, Pika 1, Faqe 5, [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#)



Andaj për ta arsyetuar rëndësinë e zbatimit të parimit të cilin po e shtjellojmë, në vazhdim kemi analizuar një rast në të cilin është shkelur parimi i lartcekur, ku një individ është targetuar si kriminel i luftës, vetëm për faktin se i takon një etnie së cilës shpesh herë krimet e luftës i atribuohen kolektivisht.

Shënjestrimi i D.G. si kriminele e luftës në Gjakovë

Në qershor të vitit 2021 në qytetin e Gjakovës ishte kthyer D.G., grua e moshuar e komunitetit serb, në banesën e cila i ishte dhënë asaj në shfrytëzim. Kjo e drejtë shfrytëzimi i ishte garantuar në vitin 1997, me vendim të Kuvendit të atëhershëm Komunal të Gjakovës, ku banesa në fakt ishte pronë e Komunës së Gjakovës, por që vendimi ia lejonte asaj që ta shfrytëzonte banesën. D.G. kishte kërkuar ri-posedimin e pronës së saj, mbi bazën e vendimit të lartcekur, kërkesë kjo e cila ishte dorëzuar në Agjensionin Kosovar për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP). Ky institucion e kishte njohur vendimin e saj dhe me këtë rast ata e kishin liruar banesën e D.G, me ç'rast ajo ishte vendosur aty më 6 qershor 2021.

Kthimi i saj kishte shkaktuar pakënaqësi të shumta, për disa ditë me radhë, tek familjarët e viktimave të luftës, tek disa organizata jo qeveritare të cilat veprojnë në këtë komunë, si dhe tek asamblistët e Komunës së Gjakovës. Të gjithë këta kishin kërkuar publikisht që ajo të largohet nga Gjakova, duke e konsideruar si person të padëshiruar në qytet dhe duke e etiketuar si kriminele të luftës. Shumica nga ta e kishin parë si provokim kthimin e saj në qytetin e Gjakovës.

Në mbledhjen e Asamblesë së Komunës së Gjakovës, më datë 28 qershor 2021, si pikë e parë e rendit të ditës u diskutua çështja e kthimit të qytetares D.G. në Gjakovë. Në këtë mbledhje një numër i asamblistëve e kritikuan kryetarin e komunës Ardian Gjini, për lejimin e kthimit të D.G. në banesën e cila i ishte dhënë në shfrytëzim nga AKKVP-ja. Disa nga asamblistët përdorën gjuhë të urrejtjes ndaj saj dhe e etiketuan si kriminele të luftës.⁴

Propozuesi i pikës për rendin e ditës në Asamblesë Komonale Ali Tafarshiku publikisht e etiketoi qytetaren si një kriminele. Në këtë mbledhje ai deklaroi “Gjakova nuk e ndalon lëvizjen e lirë. Gjakova e ndalon ardhjen e kriminelëve, për të cilët janë faktet e dëshmuara që kanë kryer krime lufte dhe Gjakova e ndalon hyrjen e çfarëdo lloj shtetasi, çfarëdo lloj etnie në pronën komunale pa procedura.” Në këtë deklaram të tij ai padrejtësisht e përfshiu atë në mesin e personave të cilët kishin kryer krime gjatë periudhës së konfliktit në Kosovë, pa ofruar asnjë provë për pretendimet e tij.

Në të njëjtën mënyrë kundër ardhjes së D.G. ishte edhe asamblistja tjetër e Komunës së Gjakovës, Mimoza Shala. Sipas saj kjo temë e prekte çdo qytetar të Gjakovës dhe deklaroi “të gjithë e dimë sa krime kanë bërë secili prej serbëve që kanë jetuar në Komunën e Gjakovës. Unë nuk e njoh dikë që ka shpëtuar pa kryer krime në komunën tonë.”

Me deklaratën e saj asamblistja ia atribuoi krimet e luftës secilit prej qytetarëve të komunitetit serb të cilët kishin jetuar në Komunën e Gjakovës, ku ndër ta ishte edhe D.G. Edhe pse Shala tha se nuk donte të paragjykonte, por shtoi se fakti se qytetarja kishte punuar si pastruese në stacionin policor në periudhën e para luftës, tregonte se ajo mund të ishte edhe pjesëmarrëse në krimet e shumta që ishin kryer në qytetin e Gjakovës.

Në replikën e Ardian Gjinit ndaj Mimoza Shalës, u tha se D.G. kishte punuar si pastruese në Policinë Serbe, fakt ky i cili nuk dëshmonte kryerje të krimeve të luftës nga ana e saj.

Edhe asamblisti Muharrem Musa gjatë deklaramit të tij tha se “për ne është e papranueshme një gjë e tillë, një ardhje e tillë e një krimineles apo çfarëdo krimineli tjetër, ne nuk do t'i pranojmë.” Pra në të njëjtën formë edhe Musa me deklaratën e tij e targetoi D.G. si kriminele, vetëm pse ishte serbe.

Nga citimet e lartcekura është e dukshme se D.G. akuzohet pa asnjë provë për krime lufte dhe krejtësisht në mënyrë të pandershme. Për më tepër edhe legjisllacioni penal në fuqi e njeh parimin e “prezumimit të pafajësisë⁵”, ku një person nuk mund të konsiderohet i fajshëm, deri sa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Prandaj në një shoqëri demokratike askush nuk ka të drejtë të jap deklaramatë të tilla publike dhe t’ia atribuojë krimet një personi, vetëm për shkak që është pjesë e një komuniteti të caktuar.

⁴ Online Video, TV Syri Vision, Mbledhja e Kuvendit Komunal Gjakovë, 28.06.2021, <https://www.facebook.com/tvsyrirevision/videos/111377627760698>

⁵ Kodi i Procedurës Penale, Neni 3, Pika 1, Faqe 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>



Pasojat e atribuimit kolektiv të fajit

Si pasojë e shënjestrimit të D.G. si kriminele e luftës, për shkak se i përkiste një etnie të caktuar, është krijuar një ambient jo miqësorë ndaj saj, ku janë marrë veprime nga individë dhe institucione, të cilat ia kanë vështirësuar realizimin e të drejtës së saj në kthim dhe të drejtat themelore të saj.

Më 28 qershor ishin paralajmëruar protesta nga familjarët e viktimave të luftës, si shkak i pakënaqësisë të cilën ia kishte shkaktuar ardhja e qytetares së komunitetit serb në Gjakovë, por që si përfundim u anuluan.

Sipas një interviste të realizuar nga ATV me D.G., ata kishin kuptuar se e njëjta ishte sulmuar disa herë, shkak ky i cili kishte bërë që të ishte nën përcjellje të vazhdueshme nga ana e Policisë së Kosovës. Qytetarët e tjerë madje edhe e kishin ngacmuar dhe e kishin sulmuar në mënyra të ndryshme. Ajo kishte deklaruar se “mi kanë gjuajtur dritaret me gurë, mi kanë dëmtuar pak. Dhe i kanë ngjitur disa fotografi, që mua më duken si kërcënim se do të më vrasin. Policia më ka siguruar, por kur policia largohet, vijnë e më ngacmojnë⁶”. Sulmet të cilat i janë bërë D.G. e kishin bërë atë që të ndihej e pasigurt për ta vazhduar qëndrimin e saj në atë banesë. Andaj si shkak i pasigurisë që kishte, më 30 qershor D.G. kishte tentuar të ndërronte derën e hyrjes së banesës së saj, mirëpo një gjë e tillë i ishte pamundësuar. Kjo për shkak se sipas njoftimit të dhënë nga Telegrafi, të cilët kishin kontaktuar me Zëdhënësin e Policisë së Kosovës në Gjakovë, Nusret Xhurkaj, thuhej se “policia nuk e lejoi D.G të vendoste derë të blinduar, sepse sipas policisë, për një gjë të tillë është e domosdoshme leja e komunës⁷. Dhe qysh nga kjo datë, D.G. ka lëshuar banesën dhe po qëndronte te motra e saj, pasi që ajo nuk po ndihej e sigurt më në atë vend⁸.

Sipas të gjitha të dhënave të mësipërme, kuptojmë se D.G. në asnjë mënyrë nuk e ka rrezikuar apo cenuar ndonjë banorë shqiptarë apo të çfarëdo komuniteti tjetër. Mbi të gjitha ajo ishte kthyer në Komunën e Gjakovës duke poseduar të gjitha dokumentet të cilat edhe do të duhej t’i kishte, në mënyrë që të mund të hynte në banesë. Prandaj kategorizimi i saj si kriminele nga qytetarët e Gjakovës dhe mvëshja e krimeve të luftës, është kundër të drejtave dhe lirive themelore të saj. Në asnjë mënyrë nuk duhet të përgjithësojmë situatën dhe të cenojmë të drejtat e një personi, si pasojë e të kaluarës së dhimbshme. Një gjë e tillë përpos që është në kundërshtim me Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën, në të njëjtën kohë është në kundërshtim edhe me parime juridike e demokratike. Atribuimi i padrejtë ndaj një personi dhe nxitja e urrejtjes ndaj së njëjtës, tejkalon përgjegjësinë morale, por mund të konsiderohet edhe si vepër penale.

Duke pasur parasysh se D.G. ka të drejtën e saj të bazuar në legjisllacionin në fuqi për t’u kthyer në banesën për të cilën ka leje për t’a shfrytëzuar, çdo pengesë tjetër e cila ia pamundëson jetësimin e të drejtave të saj, si dhe etiketimi i padrejtë me krime lufte, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin dhe frymën demokratike.

Më 6 korrik 2021 Komuna e Gjakovës kishte dorëzuar një padi në Gjykatën Themelore të Gjakovës⁹. Sipas të dhënave të cilat i ka siguruar FDHK nga Zyrtari për Informim Publik të Gjykatës Themelore të Gjakovës, Lekë Muqaj, thuhet se “Gjykata Themelore në Gjakovë, ka pranuar një padi nga Komuna e Gjakovës, për anulim të kontratës për dhënie me qira të banesës me kërkesë për masë të përkohshme.” Masa e përkohshme e sigurisë është masë e cila propozohet për sigurimin e kërkesëpadisë nga ana e paditësit në procedurë kontestimore dhe e cila mund të kërkohet mbi katër baza të ndryshme. Në ndërlidhje me padinë për të cilën po bëjmë fjalë ne, propozimi për caktimin e masës së sigurisë mund të kërkohet “në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës...¹⁰”

Pas mbajtjes së seancës dëgjimore të Gjykatës Themelore të Gjakovës, të datës 9 gusht 2021, kjo gjykatë ka refuzuar propozimin e Komunës së Gjakovës për caktimin e masës së sigurisë, me të cilin ishte kërkuar që t’i ndalohej paditëses që personalisht të qëndrojë, shfrytëzojë apo banojë në atë banesë. Gjykata kishte analizuar dhe pas vlerësimit të provave ka përfunduar se caktimi i masës së sigurisë në këtë fazë është i pabazuar dhe i panevojshëm.¹¹

⁶ Online Video, ATV, 28.06.2021, [Lajmet Qendrore të orës 19:00 - 28.06.2021 ATV - YouTube](#)

⁷ Telegrafi.com, 30.06.2021, [Dragica Gashiçit nuk i lejohet vendosja e derës së blinduar në banesën e saj në Gjakovë - Telegrafi](#)

⁸ Radio Evropa e Lirë, 06.07.2021, [Komuna e Gjakovës padit Dragica Gashiçin \(evropaelire.org\)](#)

⁹ Po aty.

¹⁰ Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 297, paragrafi 1, nënparagrafi b), Faqe 60 ([Microsoft Word - T-Ligji p\353r procedur\353n kontestimore-shqip.doc](#)) ([rks-gov.net](#))

¹¹ Facebook post, Gjykata Themelore Gjakovë, 11 gusht 2021, [Gjykata Themelore Gjakovë | Facebook](#)



Andaj me këtë aktvendim të nxjerrë nga ana e gjykatës mund të themi se u parandalua një shkelje e të drejtave elementare të qytetares, duke i mundësuar asaj që t'a përdorë edhe më tutje banesën për të cilën ajo kishte të drejtë shfrytëzimi. Para nxjerrjes së këtij vendimi kishte pasur reagime të ndryshme në lidhje me padinë e ushtruar ndaj D.G.

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë së bashku me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë, në reagimin e publikuar kishin kërkuar nga Komuna e Gjakovës që të tërheqë padinë e ushtruar, pasi ajo posedonte të gjitha dokumentet e duhura që të kthehej në Gjakovë dhe të njëjtat ishin publike. Për më tepër, Komuna e Gjakovës do të duhej që t'ia mundësonte kthimin e sigurt dhe të dinjitetshëm D.G.¹²

Për këtë rast, më 13 korrik 2021 kishte reaguar edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, e cila përmes një postimi në rrjetin social Facebook, ka thënë "Viktimat meritojnë drejtësi dhe personat e zhvendosur kanë të drejtën të kthehen në shtëpitë e tyre. Ministrat dhe kryetarët e komunave - ju lutem leni politikën anash dhe bashkëpunoni për të siguruar që të gjithë Kosovarët gëzojnë paqe dhe siguri, të lirë ndaj ngacmimit dhe frikësimit¹³".

Situata të tilla, ku personave të caktuar u mveshen keqbërjet kolektive, vijnë si pasojë e një praktike të asociimit të krimeve me etninë serbe. Por këto praktika duhet të ndërprehen, pasi secili person ka të drejtën që të mos paragjykohet padrejtësisht dhe t'i respektohen të drejtat dhe liritë e veta. Prandaj çdo cenim i të drejtave të qytetarëve, duke i targetuar si keqbërës, është jo ligjor dhe në kundërshtim me parimet e një shteti demokratik.

Rekomandimet

Në mënyrë që të zvoglohen rastet kur keqbërjet dhe krimet e luftës atribuohen kolektivisht një grupi ose etnie dhe të evitohen pasojat që kjo shkakton rekomandojmë që "Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën¹⁴", të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik si dhe mediat.

Rekomandojmë që shpifja sërish të kthehet si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, ashtu siç ka qenë edhe në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2004, e cila do të penalizohet dhe ndiqet nga prokuroria e shtetit, sidomos kur kemi të bëjmë me rastet që lidhen me krimet e luftës, pasi që sjell deri në cenimin e sigurisë së personave ndaj të cilëve bëhet shpifja.

Kërkojmë që Kuvendet Komunale dhe Kuvendi i Kosovës, si dhe institucionet tjera të përfshijnë në Kodin e Sjelljes apo rregulloret e tyre ndalimin dhe sanksionimin e atribuimit kolektiv të krimeve të luftës një grupi apo etnie nga ana e deputetëve, këshilltareve komunal dhe përfaqësuesve të institucioneve.

Mediat duhet të mbahen përgjegjëse nëse shënjëstrojnë një grup apo etni kolektivisht për kryerje të krimeve të luftës. Komisioni i pavarur i mediave duhet që të identifikojë dhe ndërmerr masa ndaj këtyre mediave apo gazetarëve.

Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.

¹² Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Reagim ndaj padisë së Komunes së Gjakovës, 08.07.2021, [Reagim ndaj padisë së Komunes së Gjakovës - Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë \(hlc-kosovo.org\)](https://www.facebook.com/kosovo.usembassy/posts/6548774871815279)

¹³ Ambasada Amerikane në Kosovë, 13.07.2021, <https://www.facebook.com/kosovo.usembassy/posts/6548774871815279>

¹⁴Principi ALB (vihr-ks.org)

 @dwpkosovo

 @dwpkosovo

 @dwpkosovo

 dwpkosovo